



KANS

KOSOVO • AIR
NAVIGATION •
SERVICES

Titulli: PR-KANS-01
Versioni: 1.0
Klasifikimi: Brendshëm
Faqe: 1 of 11

PROCEDURA E REKRUTIMIT TË KANDIDATËVE PËR STUDENT KONTROLLOR NË OFRUESIN E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR - KANS

Në zbatim të Nenit 16, 18 dhe 30 të Ligjit NR.08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe Nenit 8.3 të Rregullores për Marrëdhënien e Punës së Personelit të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Drejtori i Përgjithshëm i KANS, nxjerr këtë:

PROCEDURË E REKRUTIMIT TË KANDIDATËVE PËR STUDENT KONTROLLOR NË OFRUESIN E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR - KANS

I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Procedure është të përcaktojë proceset, kriteret dhe përgjegjësit për përzgjedhjen e Kandidatëve për Student Kontrollor që do të ndjekin programin e trajnimit për pozitën e Kontrollorit të Trafikut Ajror pranë Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror-KANS. Po ashtu kjo Procedurë do të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e Kandidatëve për Student Kontrollor.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Procedurë zbatohet për të gjithë aplikantët për t'u përzgjedhur si Kandidat - Student Kontrollor në programin e trajnimit të kontrollorëve të trafikut ajror të organizuar nga KANS, si dhe për të gjitha strukturat përgjegjëse brenda KANS për administrimin dhe zbatimin e këtij procesi.

Neni 3

Përgjegjësitë

Autoriteti përgjegjës për organizimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e procesit të rekrutimit është KANS, përmes Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Departamentit për Zhvillim dhe Trajnim.

II. THEMELIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Neni 4

Procedura e Rekrutimit

Bazuar në planin e personelit, Departamenti i Burimeve Njerëzore paraqet kërkesë për fillimin e procedurës së rekrutimit të Kandidatëve për Student Kontrollor te Drejtori i KANS.

1. Departamenti i Burimeve Njerëzore fillon procedurën e rekrutimit pas aprovimit të kërkesës nga Drejtori.

Neni 5

Kushtet e përgjithshme

1. Me Ligjin për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe me Rregullore për Marrëdhënien e Punës së Personelit të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, janë përcaktuar kushtet e përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës në KANS, si në vijim:

- 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin përkatës për Gjuhët;
- 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- 1.6. të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën;
- 1.7. të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas këtij ligji dhe akteve tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 6

Kushtet e veçanta

1. Kushtet e veçanta për aplikim për pozitën Kandidat - Student Kontrollor janë si vijon:
 - 1.1 Të jetë i/e moshës nga 18 deri në moshën 25 vjeçare;
 - 1.2 Të ketë njohuri të avancuar të gjuhës angleze;
 - 1.3 Të ketë diplomë të shkollës së mesme.

Neni 7

Shpallja e Konkursit

1. Publikimi i konkursit duhet të bëhet në ueb faqe dhe mund të bëhet edhe në platformë elektronike apo në llogaritë e KANS në rrjetet sociale.
2. Konkursi publik për plotësimin e vendeve të lira të punës për Kandidat - Student Kontrollor shpallet nga DBNJ sipas kërkesave të kësaj Procedurë.
3. Konkursi publik shpallet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe mbetet i hapur së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e publikimit.

Neni 8

Përmbajtja e konkursit

1. Konkursi publik përmban:

- 1.1. Titullin e vendit të punës;
- 1.2. Koeficientin e pagës mujore për Kandidat - Student Kontrollor të Trafikut Ajror;
- 1.3. Përmbledhje e shkurtër të përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësi kryesore;
- 1.4. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës;
- 1.5. Specifikimi i dokumenteve/dëshmimeve përkatëse për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;
- 1.6. Informata nëse emërimi është me afat të caktuar apo të pacaktuar dhe kohëzgjatja e periudhës provuese;
- 1.7. Datat e vlefshme për aplikim;
- 1.8. Mënyrën e aplikimit në konkurs;
- 1.9. Mënyrën e vlerësimit të aplikantëve dhe
- 1.10. Shënimi që aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të shqyrtohen;
- 1.11. Njoftimi rreth përzgjedhjes përfundimtare.
- 1.12. Informata rreth testimit profesional (Më shumë informata rreth FEAST mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit <http://feast-info.eurocontrol.int/>)

2. Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit:

- 2.1. Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 2.2. Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore;
- 2.3. Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar;
- 2.4. Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucione publike apo një deklaratë se nuk ka masë disiplinore në fuqi për shkelje të rëndë në sektorin jo publik.

Neni 9

Mënyra e aplikimit

1. Aplikimi për konkurset e shpallura nga KANS bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës përkatëse, apo adresës elektronike.
2. Platformat elektronike apo adresa elektronike e shfrytëzuar nga KANS për konkurse duhet të sigurojë kthimin e informatave në kohë reale mbi pranimin e dokumenteve të dërguara nga kandidati.

3. DBNJ ofron sqarime të nevojshme për kandidatët lidhur me kriteret e konkursit publik gjatë fazës së aplikimeve.
4. Formulari i Aplikacionit u vihet në dispozicion në ueb faqe të KANS.
5. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit.
6. Fletë aplikacioni me dokumentacionin përcjellës të aplikimit duhet të dorëzohet në afatin dhe adresën e përcaktuar me konkurs.

Neni 10

Verifikimi paraprak i aplikacioneve

1. Brenda shtatë (7) ditësh pas mbylljes së konkursit, DBNJ bën verifikimin paraprak të aplikacioneve, me qëllim të konstatimit të përmbushjes së kriterëve të konkursit nga aplikantët sipas aplikacioneve të pranuara dhe në këtë fazë, DBNJ nuk mund të kërkojë dokumentacion shtesë nga kandidati.
2. Për çdo aplikacion të refuzuar, DBNJ nxjerr vendim të arsyetuar, ku shtjellohen në detaje shkaqet e refuzimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
3. DBNJ harton raportin e punës të verifikimit paraprak të aplikacioneve, përfshirë listën e kandidatëve që i plotësojnë kushtet.
4. Kandidatët njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronik për rezultatet e verifikimit paraprak

Neni 11

Themelimi dhe Përbërja e Komisionit Vlerësues

1. Komisioni Vlerësues është komision ad-hoc i cili themelohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të KANS, pas mbylljes së konkursit.
2. Detyrat e Komisionit përcaktohen në vendimin për themelimin e tij, si në vijim:
 - 1.1 përzgjedh dhe cakton pyetjet për testin me shkrim;
 - 1.2 vlerëson testimin me shkrim të aplikantëve;
 - 2.3 interviston dhe vlerëson aplikantët gjatë fazës së intervistave;
 - 2.4 përgatit raportin për përzgjedhjen e aplikantëve të suksesshëm për testimin profesional;
 - 2.5 koordinon përgatitjet teknike të testimit profesional me OE të përzgjedhur për FEAST;
 - 2.6 rekomandon listën e aplikantëve të përzgjedhur sipas arritjes në testimin profesional -FEAST.

3. Komisioni Vlerësues përbëhet nga pesë (5) anëtarë, ku dy (2) prej tyre janë nga Departamenti DATS - përfshirë kryesuesin, dy (2) anëtarë tjerë nga departamentet tjera të KANS dhe një (1) anëtar nga DBNJ.

Neni 12

Vlerësimi i Kandidatëve për Student-Kontrollor

1. Vlerësimi i aplikantëve Kandidat - Student Kontrollor do të organizohet në tri faza:
 - Testimi me shkrim
 - Intervista dhe
 - Testimi profesional (FEAST - First European Air Traffic Controller Selection Test).
2. Kalimi me sukses i fazës së parë dhe fazës së dytë është parakusht për kalim në fazën e tretë të testimit – FEAST.

Neni 13

Testimi me shkrim

1. Faza e parë e vlerësimit bëhet përmes testimit me shkrim që do të organizohet në gjuhën angleze sipas praktikave evropiane të përshtatura për nevojat e KANS. Testimi do të përfshijë pyetje nga shkathtësitë dhe aftësitë e përgjithshme profesionale dhe do të zgjas 90 minuta.
2. Testi duhet të përmbajë së paku tridhjetë (30) pyetje me përgjigje të shumëfishta duke përfshirë një (1) ese. Pyetjet do të vlerësohen me nga 2 pikë, ndërsa eseja vlerësohet deri në 12 pikë.
3. Testimi me shkrim do të përmbaj natyrën e pyetjeve si në vijim:
 - 3.1. pesë (5) pyetje nga personaliteti;
 - 3.2. pesë (5) pyetje nga njohuri të përgjithshme;
 - 3.3. njëzet (20) pyetje dhe detyra profesionale (aritmetikë, fizikë, logjikë e të ngjashme dhe ese).
4. Kriteri i kalueshmërisë së testimit me shkrim është pesëdhjetë 50 pikë nga 70, sa do të ketë gjithsejtë testi.

Neni 14

Intervista

1. Faza e dytë e vlerësimit bëhet përmes intervistimit të aplikantëve që kanë kaluar me sukses fazën e parë. Intervista do të zhvillohet në gjuhën angleze dhe do të përmbajë 5 pyetje për secilin kandidat. Secili anëtar i Komisionit Vlerësues paraqet nga një (1) pyetje kandidatit dhe secila pyetje vlerësohet deri në gjashtë

(6) pikë individualisht nga secili anëtar i Komisionit Vlerësues, maksimumi i pikëve të mbledhura gjatë intervistimit është 30 pikë.

Neni 15

Vlerësimi i Testit me shkrim dhe intervistës

1. Vlerësimi i kandidatëve nga testimi me shkrim dhe intervistimi përmban gjithsej njëqind (100) pikë, shtatëdhjetë (70) pikë nga testimi me shkrim dhe tridhjetë (30) pikë nga intervista. Kalueshmëria është arritja e së paku shtatëdhjetë (70) pikëve nga dy fazat e testimit.
2. Metodologjia e vlerësimit të Testit me Shkrim dhe Intervistës, realizohet përmes mbledhjes së totalit të pikëve nga secili anëtar në përpjesëtim me numrin e anëtarëve të komisionit ad-hoc.
3. Kandidatët që kalojnë me sukses fazën e testit me shkrim dhe intervistës do t'i nënshtrohen testimit profesional.
4. Rezultati i fazës së parë dhe të dytë të testimit nuk përfshihet në rezultatet e testimit profesional.

Neni 16

Testimi profesional

1. Faza e tretë e vlerësimit të kandidatëve bëhet përmes testimit profesional (FEAST) - First European Air Traffic Controller Selection Test, testim që organizohet bazuar në udhëzimet që dalin nga Rregulloret përkatëse të EASA-së dhe të Rregulloreve të AAC-së, me te cilat kërkohet që kandidati për student-kontrollor duhet të jetë i aftë nga aspekti arsimor, mental dhe fizik.
2. Vetëm pikët e fituara në testimin profesional -FEAST, do të përcaktojnë kandidatët e përgjegjshëm për kandidat – Student Kontrollor.
3. Kandidatët e suksesshëm do të përzgjidhen bazuar në renditjen e pikëve të fituara në përputhje me numrin e kërkuar sipas konkursit dhe të njëjtit do t'i nënshtrohen kontrolleve mjekësore.

Neni 17

Kontrollet Mjekësore për Kandidat – Student Kontrollor

1. Të gjithë kandidatët e përzgjedhur pas testimit profesional, do t'i nënshtrohen kontrolleve mjekësore në AMC (Qendra e Mjekësisë së Aviacionit).

2. Të gjitha shpenzimet për kontrollet mjekësore do të mbulohen nga KANS.
3. Në rast të dështimit të ndonjërit kandidat për të kaluar testet mjekësore, ftohet kandidati i suksesshëm sipas renditjes për t'ju nënshtruar testeve mjekësore.

Neni 18
Lista përfundimtare

1. Kandidatët që kalojnë me sukses të gjitha fazat e testimit, duke përfshirë edhe kalimin e kontrolleve mjekësore, do të formojnë listën përfundimtare të kandidatëve për student kontrollor të renditur sipas pikëve të fituara në FEAST.
2. Në rastet kur dy ose më tepër kandidat kanë pike të barabarta përparësi do të ketë kandidati me i ri në moshë.
3. Kandidatë e përzgjedhur në listën përfundimtare do të nënshtrohen shkollimit profesional në një institucion ndërkombëtar të akredituar.

Neni 19
Kohëzgjatja e marrëdhënies së punës

1. Për pozitën Kandidat - Student Kontrollor, kohëzgjatja e marrëdhënies së punës do të jetë me afat të caktuar.
2. Në rastet e kalimit me sukses të fazës së parë të shkollimit, kandidati nënshkruan kontratë të re të marrëdhënies së punës me afat të caktuar si Student Kontrollor i Trafikut Ajror.
3. Në raste kur Kandidati - Student Kontrollor dështon në ndonjërin nga fazat e shkollimit i ndërpritet marrëdhënia e punës në KANS.

III. STATUSI I NËPUNËSIT NËPËR FAZA

Neni 20
Kandidat Student-Kontrollor

1. Kandidat – Student Kontrollor konsiderohet aplikanti i cili ka kaluar me sukses të gjitha fazat e testimit përkatësisht përzgjedhjes për të ndjekur shkollimin si Kandidat - Student Kontrollor për pozitën Kontrollor i Trafikut Ajror. Pas procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve të suksesshëm sipas

kësaj Procedurë, DBNJ ofron kontratën e marrëdhënies së punës për “Kandidatin për Student-Kontrollor” me afat të caktuar sipas dispozitave të Rregullores për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në KANS.

2. Detyrat dhe përgjegjësit për pozitën Kandidat – Student Kontrollor janë të përshkruar në shtojcën A të kësaj Procedure.

Neni 21 **Student-Kontrollor**

Student-Kontrollor është punonjësi i cili ka kaluar me sukses të gjitha fazat e trajnimit/shkollimit (*ab-initio*) në njërin nga qendrat evropiane për trajnimin e Kontrollorëve të Trafikut Ajror. Pas procesit trajnimit/shkollimit KANS do të organizojë trajnimin e nevojshëm praktik në vendin e punës (OJT). Ky status zgjat deri në momentin e pajisjes me Licencë të Kontrollorit të Trafikut Ajror me së paku një miratim të njësisë (Rregullorja 19/2017 e AAC-së dhe UTP), ndërsa DBNJ vazhdon kontratën e marrëdhënies së punës me afat të caktuar sipas dispozitave të Rregullores për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në KANS.

IV. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Neni 22 **Detyrimet e KANS ndaj Nëpunësit**

1. Obligohet të paguajë për shkollimin, akomodimin, ushqimin, sigurimin në udhëtim transportin në fillim dhe përfundim të trajnimit si dhe një rrugëtim vajtje/ardhje për në shtëpi gjatë kohës së trajnimit;
2. Obligohet të paguajë pagë mujore deri në Licencim me së paku një miratim.
3. Obligohet të organizojë Trajnimin në Punë (OJT) në DATS deri në Licencim me së paku një miratim;
4. KANS nuk ka asnjë përgjegjësi kontraktuale ndaj nëpunësit që nuk mund të kalojë të gjitha fazat e trajnimit në licencim.

Neni 23 **Detyrimet e Nëpunësit ndaj KANS**

1. Obligohet të punojë në KANS për 7 (shtatë) vite pandërprerë, duke filluar nga data e licencimit me së paku një miratim, përmes nënshkrimit të Kontratës me KANS.
2. Në rast të shpërndarjes së njëanshme të marrëveshjes nga ana e nëpunësit, para afatit si në paragrafin e parë të këtij neni, nëpunësi detyrohet të paguajë shumën prej 100.000,00€ (njëqindmijë euro).

3. Në rast të ndërprerjes së njëanshme të kontratës para marrjes së miratimit të parë, obligohet të paguajë të gjitha shpenzimet për përzgjedhjen dhe shkollimin e tij deri në atë moment.
4. Zotohet të ruajë kredibilitetin e KANS-së duke e përfaqësuar denjësisht atë në institutet e trajnimit dhe jo vetëm.
5. Nëpunësi nuk ka përgjegjësi ndaj KANS-së në rast të dështimit për mbërritjen e standardeve të kërkuara, në secilën prej fazave të trajnimit.

Neni 24

Skema e kompensimit të nëpunësit

1. Vlera e Gradave të skemës së kompensimit përcaktohet me Rregullore për Pozitat e Punës, Përshkrimin e vendeve të Punës dhe Kompensimin e Personelit të KANS sipas kategorisë në vijim:
 - a) Kandidat – Student Kontrollor;
 - b) Student-Kontrollor;
2. Deri në hyrje të fuqi të Skemës së kompensimit si në paragrafin 1 të këtij neni, kompensimi për këto kategori do të bëhet në pajtim me Ligjin në fuqi për Paga.

Neni 25

Ankesat në procedurat e konkurrimit

1. Pas njoftimit të raportit përfundimtar për procedurën e rekrutimit të konkursit publik, kandidati i pakënaqur me raportin përfundimtar apo me fazat paraprake të procedurës së rekrutimit, mund të parashtrojë ankesë brenda afatit 30 ditor në Komisionin për Ankesa të KANS-it.
2. Ankesa e paraqitur kundër raportit përfundimtar, pezullon rrjedhën e procesit të lidhjes së kontratës së punës me kandidatin fitues.

Neni 26

Dispozitat kalimtare

1. Hyrja në fuqi e kësaj Procedure, shfuqizon rregulloret e mëparshme për procedurat e rekrutimit të Kontrollorëve të Trafikut Ajror.

Neni 27

Hyrja në fuqi

2. Kjo Procedurë hyn në fuqi, datën e nënshkrimit nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të KANS-it.

Shtojca A:

Detyrat dhe përgjegjësit e Kandidatit - Student Kontrollor

1. Titulli i vendit të punës	Kandidat - Student Kontrollor
2. Raporton:	Menaxherit të Departamentit të Shërbimeve të Trafikut Ajror (shef Instruktor)
3. Kategoria e Pozitës	EKSPERT
5. Qëllimi i vendit të punës	
Aftësimi për licencim si Kontrollor i Trafikut Ajror.	
6. Detyrat kryesore:	
1. Mësimi i rregulloreve dhe standardeve të aviacionit civil; 2. Kuptimi i procedurave të kontrollit të trafikut ajror (ATC); 3. Studimi i navigacionit ajror, meteorologjisë, komunikimit dhe frazeologjisë standarde; 4. Zbatimi i njohurive teorike në skenarë praktikë; 5. Menaxhimi i trafikut ajror virtual në kushte të ndryshme; 6. Mësimi i menaxhimit të situatave emergjente; 7. Përdorimi i frazeologjisë së standardizuar të ICAO në komunikim me pilotët; 8. Kalimi i provimeve teorike dhe praktike për të kaluar në fazat e ardhshme të trajnimit; 9. Vlerësime psikologjike dhe të përqendrimit; 10. Ruajtja e përqendrimit maksimal dhe profesionalizmit.	
7. Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara	
1. Të demonstrojë aftësi të larta komunikuese dhe në të shkruar në gjuhën angleze ; 2. Aftësi në orientim hapësinor dhe përpunim të shpejtë të informacionit; 3. Aftësi për të menduar dhe për t'u shprehur rrjedhshëm dhe logjikshëm; 4. Aftësi për të punuar si pjesë e një ekipi por edhe i pavarur; 5. Aftësi për përdorimin e teknologjinë e bashkëkohore; 6. Të jete i moshës 18 deri 25 vjet; 7. Të ketë diplomë të shkollës së mesme.	